



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Nr.
No. 01-060/01-0040435/25
Data.
Data. 10. 09. 2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 52, par.1 dhe 2, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 46 i Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe nenit 12, par.1,2,3,4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve te përhershme në Komunë, Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

T H Ë R R E T

Mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, e cila mbahet me datën **17.09.2025** (ditë e mërkure), me fillim në orën **10:00**, në Sallën e Bordit të Drejtorëve.

Mbledhja do të ketë këtë:
REND DITE


1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Propozim-vendim për miratimin e Buxhetit Komunal të Skenderajt për vitin 2026 dhe parashikimet e buxhetit për vitin 2027 dhe 2028, me Nr.04-400/01-0038628/25, i datës 01.09.2025, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
5. Propozim-vendim me Nr.02-351/01-0040413/25, të datës 10.09.2025 për shfuqizimin në tërësi të Vendimit të kuvendit të komunës së Skenderajt me Nr.01-351/01-0031376/25, të datës 01.08.2025, (Raporton Kryetari i komunës, **z. Fadil Nura**);
6. Propozim-vendim për miratimin e Draft-Planit lokal të veprimit për barazinë gjinore 2025-2027, në Komunën e Skenderajt, me Nr.02-112/01-0039817/25, i datës 05.09.2025, (Raporton Zyrtarja për barazi gjinore **znj. Qefsere Dautaj**);
7. Të ndryshme.



KRYESUESJA E KUVENDIT
znj. Adelina Spahiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43 të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008, nenit 27 të Rregullores të punës së Kuvendit, dhe në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrat nga procesverbali i mbledhjes së KOMITETI PËR POLITIK E FINANCAT, i mbajtur me datë 21.07.2025, në ora 10:00, në sallën e bordit të drejtoreve.

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar gjashtëmujor janar-qershor 2025, me Nr.04-052/01-0026961/25, të datës 09.07.2025, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skenderajt për vitin 2024, me Nr.04-47-1123/1, të datës 26.06.2025, si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm, me Nr. 04-052/01-0026963/25, i datës 09.07.2025, (Raporton drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
6. Propozim-vendim për themelimin e poliklinikës specialiste në kuadër të QKMF-së në Komunën e Skenderajt, me Nr.02-351/01-0026564/25, të datës 10.07.2025, (Raporton U.d. i Drejtorit të QKMF-së në Skenderaj, **z. Ilir Havolli**);
7. Propozim-vendim për miratimin e raportit përfundimtar, Nr. 09-052/01-0026407/25, i datës 07.07.2025, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve, si pasojë e fatkeqësive natyrore si (era, zjarri), për periudhën janar-qershor 2025, me Nr.02-052/01-0027799/25, i datës 11.07.2025, Raporton drejtori i DSHP-së **z.Alban Shala**);
8. Të ndryshme.

Kryesuesja e kuvendit znj. Adelina Spahiu: Të nderuar anëtar KPF-së, drejtor të drejtorive, në këtë mbledhje i kemi 5 anëtarë, Besiana Thaçi bashkëngjitet gjatë mbledhjes.

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi i ditës.

-Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hap debatin, nëse nuk ka, Besiana Thaçi është bashkëngjitur mbledhjes, konstatojmë me (6) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:

-Shqyrtimi i Raportit financiar gjashtëmujor janar-qershor 2025, me Nr.04-052/01-0026961/25, të datës 09.07.2025, (Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Fjala përshëndetëse, para vetes e keni, Raportit financiar gjashtëmujor janar-qershor 2025, është raport i rregullt sipas ligjit, ky raport përcakton shpenzimet e buxhetit në këtë gjashtë mujorë, si buxhet shtesë në këtë gjashtë mujorë i kemi pas 194,930.63€, të hyra të bartura nga viti i kaluar, dhe tani i kemi në shpenzim gjatë vitit aktual nen menaxhim 20,076,401.63€, ky buxhete në këtë gjashtë mujorë është shpenzuar në 53.92%, në Paga dhe shtesa 51.28%, Mallra dhe shërbime 61.53%, Shërbime komunale 54.79%,

Subvencione 61.19%, dhe Shpenzimet komunale 53.49%. Të hyrat komunale janë të realizuara në 42.83%, në Kategorinë e mallrave dhe shpenzimeve janë shpenzuar 1,808,347.03€, po me vendime gjyqësore nga kjo kategori janë shpenzuar 285,925.76€, që 15% e këtij shpenzimi ka ndodhur me vendime gjyqësore. Projektet kapitale i kemi në fq.10 të planifikuar, të shpenzuar sipas planit, në 53.49%, po 750,751.35€ janë shpenzuar me vendime gjyqësore nga kategoria e projekteve kapitale. Në fq.12 i kemi shpenzimet sipas programeve drejtorive dhe zyrave, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: E hap debatin, nëse nuk ka, shkojmë në votim, konstatojmë me (4) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim rekomandohet për kuvend për përkrahje Shqyrtimi i Raportit financiar jashtëmuajor janar-qershor 2025, me Nr.04-052/01-0026961/25, të datës 09.07.2025.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës;

-Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skenderajt për vitin 2024, me Nr.04-47-1123/1, të datës 26.06.2025, si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm, Nr. 04-052/01-0026963/25, i datës 09.07.2025, (Raporton)

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu; Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skenderajt për vitin 2024, e kemi marr me kohë dhe janë të gjeturat dhe rekomandimet që janë dhënë, kemi ndryshime edhe në opinion, rezultat në vendime gjyqësore në kontrata kolektive kanë ndikuar jo vetëm të na, po edhe shume komuna tjera të i ulet opinionin, këna pas gjithë opinion të pamodifikuar tani kemi opinion të kualifikuar. Janë 6 të gjetura të reja që janë të cekura në raporte, 4 janë rekomandime të përsëritura dhe një është i përsëritur pjesërisht. Kryetari ka formua grupin punues për hartimin e planit të implementimit të këtyre rekomandimeve që janë përgjegjës të cilët i ka atakua raportit, ky plan i implementimit të rekomandimeve i është dorëzuar ZKA-së që është i bashkangjitur materialit, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: E hap debatin, nëse nuk ka, shkojmë në votim, konstatojmë me (4) vota për, (0) kundër dhe (2) abstenim rekomandohet për kuvend për përkrahje Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skenderajt për vitin 2024, me Nr.04-47-1123/1, të datës 26.06.2025, si dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit ditës;

-Propozim-vendim për Themelimin e poliklinikës specialistike në kuadër të QKMF-së në Komunën e Skenderajt, me Nr.02-351/01-0026564/25, të datës 10.07.2025, (Raporton);

U.d. i Drejtorit të QKMF-së në Skenderaj, Ilir Havolli; Fjala përshëndetëse, duke u bazuar në nevojat e shtuar për shërbime specialistikë mjekësorë në komunën tonë, si dhe interes në përmasimin e qasjes së qytetarëve në shërbime cilësore gjithëpërfshirëse, ne e kemi dërgua një kërkesë për themelimin e poliklinikës specialistikë, dhe sot kësaj kërkesë po ja shtojmë edhe një kërkesë për hemodializës në kuadër të kujdesit shëndetësor publik. Arsyeimi i kësaj kërkesë është, numri i lartë i specialistëve duke u bazuar në vitin 2024 kemi gjithsej 6167 referime specialistike jashtë komunës tonë, dhe 3537 raporte spitalore, që gjithsej 10 mijë kërkesa për shërbime specialistike. Prandaj ne kërkojmë që kjo poliklinikë të themelohet, dhe të dërgojmë këtë vendim në MSH, dhe të marrim dritën jeshile nga ministria, dhe shpenzimet janë zero që faktikisht realizohen përmes buxhetit të qeverisë. Kur jemi të hemodializa ne i kemi 9 raste të cilët i transportojmë në Runik, Qubrel, Qirez, ku i kemi dy autoambulanca, ku njëra brenda muajt i realizon 2800km dhe tjetra 3000km dhe ne total është një kosto financiare e lartë.

Kryesuesja: E hap debatin, fjalën ja kaloj:

Mentor Mehmeti-PDK: Fjala përshëndetëse, faleminderit që e keni sjellë këtë pikë, është me së e nevojshme për qytetaret që kanë nevojë për raporte specialistike, mua me intereson cilat drejtime specialistike hynë në kuadër të kësaj poliklinike? Dhe pajisjet a ekzistojnë a janë të mjaftueshme në QKMF, që këto shërbime të kryhen në momentin kur personi ka nevojë për drejtime adekuate?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

U.d. i Drejtorit të QKMF-së në Skenderaj, Ilir Havolli: Ne momentin kur realizohet kjo poliklinik edhe e marrin vendimin nga MSH, neve na lejohet ti ofrojmë 16 shërbime specialistike, ne kishim ofrua shërbime specialistike primare dhe esenciale, hemodializa e deri të shërbimet tjera që janë të nevojshme imediatë për qytetarin. Të aparature, ne momentin që MSH e nxjerr vendimin atëherë reparti i kalon komunës SKUK-së dhe ajo e pajise me aparaturë poliklinikën, përmes donatorëve të ndryshme etje etje.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Mentor Mehmeti-PDK: A keni me pas kardiolog, endokrinolog, dermatolog apo çfarë profilesh ka me pas?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

U.d. i Drejtorit të QKMF-së në Skenderaj, Ilir Havolli: Ne e kemi pas imediate në komunën tonë është kardiologu, ortopedi, fiziatri,, kur jemi të fiziatri ne e kemi futur në plan program për vitin 2026, ju e dini së ekziston gjinekologjia në QKMF, po tani me udhëzimin e kujdesit parësor shëndetësor nuk lejohet një gjë e tillë, është e pa prekur edhe shume shërbime tjera, e kemi polmologjin ku ka funksionuar në të kaluarën tash nuk kemi si shërbim, e kemi një specialist të polmologjisë që ende nuk është i kyqyr dhe ka vullnet me u kyq.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

Mentor Mehmeti-PDK: Në material kisha kërkuar që të vendosen këto informacione shtesë, për shkak së me ditë asamblistit kur të prezanton në asamble sepse është i mangët materiali.

Alketa Mecini-IDEAL: Fjala përshëndetëse, thatë se e kemi një specialist të polmologjisë, qysh e keni atë?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj;

U.d. i Drejtorit të QKMF-së në Skenderaj, Ilir Havolli: Ne shkojmë si poliklinik specialistike dhe me hemodializ, dhe gjitha materialin ka me vendos. Specialisti i polmologjisë është jashtë QKMF-së aj punon privat, dhe aj është i gatshëm me ardhur me punua.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, shkojmë në votim, konstatojmë me (6) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim, Propozim-vendim për Themelimin e poliklinikës specialistike në kuadër të QKMF-së në Komunën e Skenderajt.

Vazhdojmë me piken 7 të rendit ditës;

-Propozim-vendim për miratimin e raportit përfundimtar, Nr. 09-052/01-0026407/25, i datës 07.07.2025, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve, si pasojë e fatkeqësive natyrore si (era, zjarri), për periudhën janar-qershor 2025, me Nr.02-052/01-0027799/25, i datës 11.07.2025, (Raporton);

Drejtori i DSHP-së Alban Shala; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Propozim-vendim për miratimin e raportit përfundimtar i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve, si pasojë e fatkeqësive natyrore si (era, zjarri), për periudhën janar-qershor 2025, Dëme janë shkaktuar në bujqësi dhe në ekonomi familjare, në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale prej 217,481.49€, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: e hape debatin nëse nuk ka, konstatojmë me (6) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për miratim Propozim-vendim për miratimin e raportit

përfundimtar, Nr. 09-052/01-0026407/25, i datës 07.07.2025, i hartuar nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve, si pasojë e fatkeqësive natyrore si (era, zjarri), për periudhën janar-qershor 2025.

Vazhdojmë me piken 8 të rendit ditës;

-Të ndryshëm; e hap debatin, nëse nuk ka, me kaq e mbyllim këtë mbledhje shihmi në seancë e kuvendit, për date ju njoftojmë përmes emaili, gjitha të mirat.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit





REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRI I BUDJETIT DHE FINANCËVE
KOSOVA

No. 04-400/01-0038628/25
Data 01-09-2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Skenderaj
Skupština Opštine Skenderaj
Skenderaj Municipal Assembly

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

DATË/A:	01.09.2025
PËR/ZA/TO:	znj. Adelina Spahiu, Kryesuese e Kuvendit
NGA/OD/FROM:	Kryetari i Komunës z. Fadil Nura
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtorit për Buxhet dhe Financa z. Ismet Aliu
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim-Vendimi i Buxhetit Komunal për vitin 2026 dhe Parashikimi i Buxhetit 2027-2028

E nderuara znj. Spahiu

Bashkangjitur me këtë shkresë po ju dërgojmë Propozim-Vendimin e Buxhetit Komunal për vitin 2026 dhe Parashikimin e Buxhetit 2027-2028.

Hartimi i buxhetit komunal përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2026/01 dhe 2026/02 të lëshuar nga Ministri i Financave, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit (LMFPP).

Ky material cakton kufijt final të shpenzimeve sipas kategorive kryesore ekonomike, dhe sipas programeve-nen programeve të bazuara në Statutin e Komunës. Ne synojmë që propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarje buxhetore t'ia dorëzojmë Kuvendit Komunal deri me datën 1 shtator 2025, bazuar në nenin 62.1 të LMFPP-së. Materiali është i bazuar në kërkesat finale për shpenzime të paraqitura nga mbajtësit e buxheteve, dhe si i tillë kërkohet të shqyrtohet në Komitetin për Politikë dhe Financa më se largu më **17 shtator 2025**.

Bashkëngjitur:

- Propozim Vendimin e Buxhetit Komunal 2026 dhe Parashikimi për vitet 2027-2028, dhe
- Listën e Projekteve Kapitale 2026-2028.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Kryetari i Komunës në bazë kompetencave të përcaktuara me nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 15, nenin 50 paragrafi 1 shkronja h) të Statutit Nr.01-110-385 të Komunës së Skenderajt i datës 03.12.2008, dhe nenin 61 parag.1 të Ligjit nr.03/L-048 nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, plotësuar ndryshuar me ligjin 04/L-116, plotësuar ndryshuar me ligjin 03/L-221, plotësuar ndryshuar me ligjin 03/L-194 plotësuar ndryshuar me ligjin 05/L-063, plotësuar ndryshuar me ligjin 05/L-007, Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Skenderajt në mbledhjen e rregullt të datës _____ Kryetari i Komunës, propozon këtë:

PROPOZIM PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR VITIN 2026 DHE PARASHIKIMET E BUXHETIT 2027-2028

Neni 1

Propozohet miratimi i Vendimit për Buxhetin e Komunës së Skenderajt, për vitin 2026 si dhe parashikimi i buxhetit për vitin 2027-2028 si në vijim :

- Buxheti për vitin 2026 në shumë prej..... **20,245,395.00 €** ,
- Parashikimi për vitin 2027 në shumë prej..... **21,210,659.00 €**,
- Parashikimi për vitin 2028 në shumë prej..... **22,239,122.00 €**

Neni 2

Të hyrat e Buxhetit të Komunës nga neni një i këtij propozimi planifikohen të realizohen nga dy burime:

- Grandet e Qeverisë,
- Burimi i të hyrave vetanake.

Komuna gjatë viteve në vijim, mund ti realizojë mjetet nga donacionet dhe participimi i qytetarëve. Mjetet nga participimi dhe donacionet nga personat fizik apo juridik do të jenë pjesë e këtij buxheti dhe do ta rrisin buxhetin, varësisht nga viti që do të ndodhë. Rritja e buxhetit do të bëhet vetëm kur të transferohen mjetet në xhirollogarinë e Komunës.

Neni 3

Të hyrat e Komunës planifikohen të realizohen sipas tabelës vijon:

Burimet e Financimit	Buxheti 2026	Vlerësimet 2027	Vlerësimet 2028
Granti i përgjithshëm	8,450,648.00	9,014,011.00	9,734,241.00
Granti për arsim	7,670,086.00	7,900,189.00	8,137,194.00
Granti për shëndetësi	2,183,749.00	2,249,262.00	2,316,740.00
Transferi i Shërbim. Rezide.	200,000.00	200,000.00	200,000.00
Të hyrat vetanake	1,740,912.00	1,847,197.00	1,850,947.00
GJITHSEJ TË HYRAT	20,245,395.00	21,210,659.00	22,239,122.00

Neni 4

Shpenzimet për vitin 2026-2027 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve dhe sipas viteve si me poshtë vijon:

Viti 2026

BUXHETI TOTAL 2026 NGA DY BURIMET							
Drejtoritë/Programet	Stafi	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
Shpenzimet							
ADMINISTRATA KOMUNALE	1,368	2,575,900	1,659,348	158,000	1,190,000	3,041,615	8,624,863
Zyra e Kryetarit	22	248,500	50,000	-	275,000	-	573,500
Prokurimi	6	52,500	12,000				64,500
Administrata dhe Personeli	39	308,200	169,100	-	-	40,000	517,300
Çështjet gjinore	3	26,800	11,700	-	-	-	38,500
Inspektimet	10	103,000	130,000	-	-	-	233,000
Zyra e Kuvendit Komunal	27	297,000	20,000	-	-	-	317,000
Buxhet dhe Financa	24	198,500	34,500	-	-	260,000	493,000
Shërbime Publike	39	351,500	800,798	154,000	210,000	365,000	1,881,298
Zyra komunale për komunitete	8	65,100	18,000	-	-	-	83,100
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	12	97,500	37,750	-	160,000	-	295,250
Zhvillim ekonomik, inovacion, ndërmarrësi dhe turizëm	10	90,000	76,500	-	130,000	90,000	386,500
Kadastër dhe Gjeodezi	16	125,000	20,000	-	-	-	145,000
Planifikimi Urban dhe Mjedisi	12	125,500	165,000	-	-	2,286,615	2,577,115
Kulturë, Rini dhe Sport	21	167,500	42,000	-	195,000	-	404,500
Administrata e Arsimit	10	74,300	25,000	-	100,000	-	199,300
Administrata e Shëndetësisë	10	75,000	17,000	-	120,000	-	212,000
Shërbimet Sociale	17	170,000	30,000	4,000	-	-	204,000
SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	199	1,940,000	626,052	62,400	-	-	2,628,452
Shërbimet Rezidenciale	13	159,526	75,000	10,000	-	15,000	259,526
ARSIM DHE SHKENCË	870	7,797,000	820,721	61,500	-	53,333	8,732,554
Arsimi Parashkollor dhe Çerdhet	55	375,000	154,472	6,000	-	-	535,472
Arsimi Fillor	685	6,255,000	549,144	42,500	-	53,333	6,899,977
Arsimi i Mesëm	130	1,167,000	117,105	13,000	-	-	1,297,105
Totali i shpenzimit të buxhetit	1,368	12,472,426	3,181,121	291,900	1,190,000	3,109,947	20,245,395
	%	61.61	15.71	1.44	5.88	15.36	100.00

Viti 2027

BUXHETI TOTAL 2027 NGA DY BURIMET								
Skenderaj	Drejtoritë/Programet	Stafi	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
Shpenzimet								
	ADMINISTRATA KOMUNALE	286	2,602,300	1,626,600	161,100	1,200,000	3,751,810	9,341,810
	Zyra e Kryetarit	22	250,000.0	60,000	-	275,000	-	585,000.00
	Prokurimi	6	52,500.0	18,000	-	-	-	70,500.00
	Administrata dhe Personeli	39	311,200.0	174,500	-	-	-	485,700.00
	Çështjet gjinore	3	27,200.0	13,200	-	-	-	40,400.00
	Inspektimet	10	104,500.0	125,000	-	-	-	229,500.00
	Zyra e Kuvendit Komunal	27	298,000.0	31,000	-	-	-	329,000.00
	Buxhet dhe Financa	24	201,200.0	38,500	-	-	270,000	509,700.00
	Shërbime Publike	39	353,200.0	720,500	157,100	210,000	364,000	1,804,800.00
	Zyra komunale për komunitete	8	66,000.0	20,000	-	-	-	86,000.00
	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	12	99,500.0	43,400	-	170,000	-	312,900.00
	Zhvillim ekonomik, inovacion, ndërmarrësi dhe turizëm	10	92,000.0	40,500	-	130,000	85,000	347,500.00
	Kadastër dhe Gjeodezi	16	125,000.0	31,500	-	-	-	156,500.00
	Planifikimi Urban dhe Mjedis	12	125,500.0	174,000	-	-	3,032,810	3,332,310.00
	Kulturë, Rini dhe Sport	21	167,500.0	57,500	-	195,000	-	420,000.00
	Administrata e Arsimit	10	77,500.0	23,500	-	100,000	-	201,000.00
	Administrata e Shëndetësisë	10	78,000.0	22,500	-	120,000	-	220,500.00
	Shërbimet Sociale	17	173,500.0	33,000	4,000	-	-	210,500.00
	SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	195	1,945,000.0	671,500	65,000	-	-	2,681,500.00
	Shërbimet rezidenciale	17	163,500	75,000	10,000	-	15,000	263,500.00
	ARSIM DHE SHKENCË	870	7,823,989	848,021	65,800	-	186,039	8,923,849.00
	Arsimi parashkollor dhe çerdhet	55	381,500	161,021	6,800	-	-	549,321.00
	Arsimi fillor	680	6,244,000	556,000	44,000	-	186,039	7,030,039.00
	Arsimi i mesëm	135	1,198,489	131,000	15,000	-	-	1,344,489.00
	Totali i shpenzimit të buxhetit	1,368	12,534,789	3,221,121	301,900	1,200,000	3,952,849	21,210,659
		%	59.10	15.19	1.42	5.66	18.64	100.00

Viti 2028

BUXHETI TOTAL 2028 NGA DY BURIMET								
Skenderaj	Drejtoritë/Programet	Stafi	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
Shpenzimet								
	ADMINISTRATA KOMUNALE	286	2,611,300	1,608,200	157,410	1,200,000	4,496,300	10,073,210
	Zyra e Kryetarit	22	250,000	60,000.00	-	255,000.00	-	565,000.00
	Prokurimi	6	55,000	13,500.00	-	-	-	68,500.00
	Administrata dhe Personeli	39	313,000	226,100.00	-	-	-	539,100.00
	Çështjet gjinore	3	28,000	12,600.00	-	-	-	40,600.00
	Inspektimet	10	105,000	125,500.00	-	-	-	230,500.00
	Zyra e Kuvendit Komunal	27	299,500	30,000.00	-	-	-	329,500.00
	Buxhet dhe Financa	24	199,500	34,500.00	-	-	320,000.00	554,000.00
	Shërbime Publike	39	358,500	680,000.00	153,410.00	210,000.00	90,000.00	1,491,910.00
	Zyra komunale për komunitete	8	66,500	20,000.00	-	-	-	86,500.00
	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	12	98,500	41,500.00	-	190,000.00	-	330,000.00
	Zhvillim ekonomik, inovacion, ndërmarrësi dhe turizëm	10	92,000	41,500.00	-	130,000.00	150,000.00	413,500.00
	Kadastër dhe Gjeodezi	16	126,500	28,000.00	-	-	-	154,500.00
	Planifikimi Urban dhe Mjedis	12	126,300	170,000.00	-	-	3,936,300.29	4,232,600.29
	Kulturë, Rini dhe Sport	21	169,000	50,000.00	-	195,000.00	-	414,000.00
	Administrata e Arsimit	10	75,500	25,000.00	-	100,000.00	-	200,500.00
	Administrata e Shëndetësisë	10	76,500	20,000.00	-	120,000.00	-	216,500.00
	Shërbimet Sociale	17	172,000	30,000.00	4,000.00	-	-	206,000.00
	SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	195	1,985,000	623,500.00	62,500.00	-	-	2,671,000.00
	Shërbimet Rezidenciale	17	168,000	150,000.00	10,000.00	-	15,000.00	343,000.00
	ARSIM DHE SHKENCË	870	7,833,163	849,421	71,990	-	397,338	9,151,911.71
	Arsimi parashkollor dhe çerdhet	55	382,000	159,500	8,490	-	-	549,990.00
	Arsimi fillor	680	6,265,000	559,921	45,500	-	397,338	7,267,758.71
	Arsimi i mesëm	135	1,186,163	130,000	18,000	-	-	1,334,163.00
	Totali i shpenzimit të buxhetit	1,368	12,597,463	3,231,121	301,900	1,200,000	4,908,638	22,239,122
		%	56.65	14.53	1.36	5.40	22.07	100.00

Neni 5

Mjetet për Paga dhe Shtesa të përcaktuara dhe të aprovuara më këtë vendim do të shpenzohen për pagimin e stafit të tre (3) Sektorëve kryesor të Komunës. Në sektorët e Komunës më këtë buxhet janë të lejuar të financohen 1368 pozita duke përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit Komunal - Qarkorja Buxhetore 2026/02. Është rrit numri i zyrtareve për 10 pozita: të Arsimit para fillor (6) dhe shëndetësia primare (4), por i reduktuar për 4 tjera të anëtarët e Kuvendit Komunal.

Pagat e aprovuara të stafit më këtë vendim, nuk mund të rriten gjatë vitit fiskal më përjashtim të rritjes së lejuar me vendim të Qeverisë.

Neni 6

Mjetet për Mallra dhe Shërbime si dhe Shërbime Komunale për vitin 2026-2028, janë të planifikuara dhe aprovuara, sipas programeve, nën programeve buxhetore për plotësimin e nevojave gjatë viteve, por gjithë herë duke pas parasysh mundësitë e kursimeve.

Neni 7

Mjetet për Subvencione-Transfero të aprovuar në nenin 4 të këtij vendimi do të shpenzohen për projekte të ndryshme të cilat i kanë propozuar programet buxhetore dhe do të shpenzohen në bazë të kritereve të përcaktuar me Rregullat e përcaktuara nga Departamenti i thesarit – MF-i, si dhe rregulloret e brendshme për subvencione.

Neni 8

Mjetet për Shpenzime Kapitale të aprovuar në nenin 4 të këtij vendimi do të shpenzohen për projekte të aprovuara dhe të paraqitura në sistemin e PIP-it.

Pjesë e këtij vendimi është edhe Lista e projekteve kapitale për tri vite.

Neni 9

Propozim Buxheti për vitin 2026-2028 është bazuar në Qarkoret Buxhetore 2026/01 dhe 2026/02 për Komunitet të lëshuar nga Ministria e Financave.

I dërgohet:

- 1.DBF-së
- 2.Kryesueses së Kuvendit
3. Arkivit të Komunës



Kryetari i Komunës

Z.Fadil Nura

LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2026-2028					VITEI		
EMERTIMI I PROJEKTEVE		Statusi	2026	2027	2028		
1	Furnizimi dhe montimi më Qillera për objektin e Komunës	I ri	40,000.00				
2	Fondi i bashkëfinancimit (DBF)	Vazhdim	260,000.00	270,000.00	320,000.00		
3	Riparimi dhe zgjerimi i vëndaljeve për autobusë dhe mbulimi i tyre	Vazhdim	85,000.00	84,000.00	10,000.00		
4	Blerja e pajisjeve motorike për miremбайtjen e qytetit	Vazhdim	30,000.00	30,000.00			
5	Ndërtimi publik ne Qytet dhe Bashkësit Lokale	Vazhdim	250,000.00	250,000.00	80,000.00		
6	Shenjëzimi dhe ndërtimi i shtigjeve të ciklizmit në qytet	I ri	70,000.00		50,000.00		
7	Shenjëzimi i shtigjeve për ecje në zonën e Çyçavicë	I ri	20,000.00				
8	Ndërtimi i zonave rekreative në qytet	I ri		85,000.00			
9	Shenjëzimi i pikave me karakter kulturo-historik në Skenderaj	I ri			100,000.00		
10	Trotuarët dhe ndriqimi në BL Likovc,Klinë e Epërme, Polac,Runik,Turigevc	vazhdim	10,000.00				
11	Unaza e brendshme 3 krahë kah Lausha	vazhdim	158,375.96				
12	Riparimi dhe rregullimi i parkut "Idriz Rreci" dhe "Shaban Polluzha"	vazhdim	100,000.00	99,500.00			
13	Riparimi dhe asfaltimi i rrugëve në qytet	vazhdim	220,500.00	440,500.20	150,000.00		
14	Kanalizimi Aqarevë - Kopiliq i ulët dhe në BL , Runik, Prekaz , Turigevc, Qirez, Rezallë, Klina e eperme Polac dhe qytet	vazhdim	210,000.00	377,126.79			
15	Ndërtimi i kolektorit Laushë-Tushilë-Aqarevë faza I	vazhdim	50,000.00	250,000.00	350,000.00		
16	Kanalizimi Syrganë, Banjë - Pemishtë	vazhdim	20,000.00	147,950.00			
17	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellsit në Burojë	vazhdim	64,560.62				
18	Rregullimi i kulmit të objekteve- banesat e kuqe	vazhdim	50,000.00	38,500.00			
19	Punimi i rrjetit të ujësjellsit në BL Qirez	vazhdim	150,000.00	267,217.50	417,217.50		
20	Ndërtimi i muzeut dhe bibliotekës së qytetit	vazhdim	150,000.00	231,254.85	300,000.00		
21	Rregullimi i subqendrës -Likovc	vazhdim	285,852.52	200,000.00			
22	Rregullimi i subqendrës -Runik	vazhdim	107,000.00	100,364.52	100,000.00		
23	Rregullimi i subqendrës -Qirez	vazhdim	111,946.68	200,364.52	100,000.00		
24	Ndërtimi i Objektit të kompleksit i UÇK-së - Objekti Ç-së	vazhdim	100,000.00	200,000.00	1,650,000.00		
25	Ndërtimi i Objektit të kompleksit i UÇK-së -Objekti K-së	I ri			100,000.00		
26	Rregullimi i subqendrës - Klinë e Epërme	vazhdim	50,000.00	90,000.00	250,000.00		

27	Tribunat ne stadiumin të qytetit	vazhdim	50,000.00	54,000.00	200,000.00
28	Kanalizimi Klinë - Kuqicë	vazhdim	50,020.00		
29	Asfaltimi i rrugëve lokale në Bl. Likofc, Turqefc, Runik, Polac, Klin, Prekaz, Qirez	liri	40,000.00	90,000.00	39,083.79
30	Rrëth-rrrotullimi në hyrje të kompleksit - Prekaz dhe nënkallimi në sheshin Adem Jashari	liri	40,000.00	40,000.00	30,000.00
31	Asfaltimi, riparimi dhe kubëzimi i rrugëve në qytet dhe Bl. Likovc, Turqevc, Runik, Qirez	vazhdim	268,358.22	206,031.62	250,000.00
32	Pajisje për lavantëri	liri	15,000.00	15,000.00	15,000.00
33	Furnizimi me pajisje, kabinete dhe laboratore shkollore	vazhdim	-	75,000.00	65,443.71
34	Furnizimi me tabela interaktive - digjitale	vazhdim	53,333.00	30,000.00	50,000.00
35	Ndërtimi i këndeve për lojëra në shkolla	liri		30,000.00	50,000.00
36	Digjitalizimi i shkollave	liri		30,000.00	200,000.00
37	Furnizim me kabinete për Informatikë	liri			31,894.00
38	Rregullimi i rrethojave dhe i ndriçimit në shkolla	liri		21,039.00	
	TOTALI:		3,109,947.00	3,952,849.00	4,908,639.00

Skenderaj 01.09.2025



Planifikimi i mallërave dhe shërbimeve dhe shërbimeve komunale

Nr. r.	Emërtimi i shpenzimeve	Kodi ekonomik	Planifikikimi sipas viteve :		
			2026	2027	2028
1	Transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendi	13140	3,550	3,660	3,670
2	Para xhepi /Meditje për udhëtim jashtë vendit	13141	2,250	1,860	1,970
3	Akomodimi-Udhëtimet zyrtare jashtë vendi	13142	2,950	3,960	3,960
4	Shpenzimet tjera për udhëtimet zyrtare jashtë vendi	13143	3,458	6,260	5,670
5	Interneti	13310	14,620	18,030	18,240
6	Telefonia mobile	13320	23,140	23,650	22,160
7	Shpenzime postare	13330	8,410	10,020	11,380
8	Shërbimet e arsimit/trajnitimit	13410	21,300	20,200	20,400
9	Shërbime këshillëdhënëse dhe profesionale	13440	10,500	13,021	13,650
10	Shërbimet e veqanta -Konsulentë dhe Kontraktorë individual	13445	11,600	13,600	12,500
11	Sherbimet shtypjes /Printim	13450	72,062	84,860	80,670
12	Sherbime kontraktuese tjera	13460	802,651	760,930	735,991
13	Sherbime teknike	13470	12,000	10,000	11,000
14	Mobiljet	13501	16,500	11,000	12,000
15	Kompjuteret	13503	54,250	55,950	47,360
16	Makinat fotokopjuese - multifunksionale	13505	5,600	3,400	4,210
17	Pajisjet e tjera	13509	2,000	4,200	4,000
18	Furnizimet për zyrë	13610	100,250	110,250	110,510
19	Furnizimet me dokumente blloko	13611	36,550	35,650	40,060
20	Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	13620	76,150	81,050	81,460
21	Furnizimet mjekësore	13630	135,000	137,000	145,000
22	Furnizimet e pastrimit	13640	60,400	64,400	62,400
23	Furnizimi me Veshmbathje	13650	14,000	14,500	13,200
24	Vaji	13710	26,300	28,200	26,700
25	Nafta për ngrohje qendrore	13720	71,000	69,000	77,500
26	Drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje	13760	295,000	295,000	295,000
27	Derivate per automjete, Gjeneratorë dhe makineri	13780	85,500	87,000	87,500
28	Avancë (paradhënia) për udhëtime zyrtare	13820	14,350	15,350	15,360
29	Rexhistrimi i automjeteve	13950	11,950	12,450	12,660
30	Sigurim i automjeteve	13951	29,550	31,050	34,570
31	Sigurimi fizik i objekteve publike	13475	240,000	245,000	245,000
32	Sigurimi i ndërtesave dhe të tjera	13953	8,100	9,100	10,200
33	Kontrollimi teknik i automjeteve	13954	1,830	1,770	1,720
34	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	14010	47,550	56,150	65,450
35	Mirëmbajtja e ndërtesave të banimit	14020	2,000	2,000	2,000
36	Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste	14022	85,000	85,000	90,000
37	Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore	14023	100,000	110,000	100,000
38	Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore	14024	50,000	50,000	55,000
39	Mirëmbajtja e objekteve kulturore	14027	13,500	14,000	15,000
40	Mirëmbajtja e rrugëve lokale	14032	290,000	290,000	290,000
41	Mirëmbajtja e teknologjisë informative dhe të komunikimit	14040	9,300	7,500	9,000
42	Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve	14050	145,800	150,000	160,000
43	Mirëmbajtja rutinore	14060	105,700	110,000	112,000
44	Reklammat dhe konkurset	14210	38,000	42,500	41,500
45	Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit	14310	21,500	22,600	23,500
Gjithsej: Mallëra dhe shërbime			3,181,121	3,221,121	3,231,121
1	Energjia Elektrike	13210	194,900	198,500	198,500
2	Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	13220	40,500	45,500	45,500
3	Mbeturinat	13230	54,000	55,200	55,200
4	Telefonia fikse	13250	2,500	2,700	2,700
Gjithsej: Shërbimet komunale			291,900	301,900	301,900

Skenderaj 09.09.2025

z.Fadil Nura
Kryetar i Komunes





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Nr. 02-351/01-0040413/2
No. 10-09-2025
Data: 10-09-2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja h) nderlidhur me nenin 12 shkronja d), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ndërlidhur me nenin 53, nenin 57 parag.1 dhe nenin 58 parag.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 50 paragr. 50.1 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Raportin e vlerësimit të ligjshmërisë nr.05/6326, dt. 21.08.2025 të MSh-së, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës në mbledhjen e datës _____2025, Kryetari i Komunës i:

PROPOZON

- I. Miratimin e vendimit për **shfuqizimin** në tërësi të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Skenderajt Nr.01-351/01-0031376/25, të datës 01.08.2025, për Themelimin e Poliklinikës Specialistike me Njësinë e Hemodializës në Komunën e Skenderajt.
- II. Vendimi i cekur në pikën I, propozohet të shfuqizohet me arsyetimin se në raportin e vlerësimit të ligjshmërisë nr.05/6326 të datës 21.08.2025 të MSh-së, përkundër vendimit të miratuar konform legjislacionit në fuqi dhe procedurave të Kuvendit, është kërkuar që kjo çështje të adresohet me një kërkesë drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë.
- III. Ky propozim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Bashkangjitur këtij propozimi dokumentacioni në tërësi si vijon: Vendimi Nr.01-351/01-0031376/25, të datës 01.08.2025, Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë nr.05/6326 të datës 21.08.2025, dhe shkresat tjera përcjellëse lidhur me çështjen.



Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së

Kryetari i Komunës

Fadil Nura





Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

1x1 Arkivit,
1x1 Zyrës së Kryetarit,
1x1 DSHMS-së,
1x1 MAPL-së,
1x1 Dosjes.





Ministria e Shëndetësisë Ministry of Health	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministry of Local Government Administration
2.2	0.5-6326
7	20/08/2025
Prishtëri / Pristina	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Ligjor/Pravni Departament/Legal Department

Për :	Z. Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL
Kopje:	Kryetari i Komunës së Skenderajt Kryesuesi i KK - Skenderaj Njësia për Administrimin e dokumenteve në MAPL Z. Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm MAPL Z. Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të Komunës dhe Kryetarit të Komunës Znj. Donjeta Cakolli, Zyrtare e lartë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktëve të Komunës Dr. Shaban Osmanaj, Udhëheqës i Divizionit të kujdesit parësor
Përmes:	Dr. Arsim Berisha, Zv.Ministër i Shëndetësisë z.Jahë Gecaj, Zyrtar përgjegjës i zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në MSh
Nga:	Afërdita Hoxha, Drejtor i Departamentit Ligjor në MSh
Zyrtarët përgjegjës:	Kadrije Sherifi, Udhëheqëse e Divizionit për mbikëqyrje dhe zbatim të Legjislacionit/MSh
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Skenderajt
Lloji i aktit:	Vendimi nr.01-0031376/25, datës 01/08/2025 për themelimin e Poliklinikës Specialistike me njësinë e Hemodializës në Komunën e Skenderajt

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration		
Data:	21.08.2025	
Njësia organizative	Nr. Lënda	Vlera
-VI-	020	483/2



I nderuar z.Hetemi,

Ministria e Shëndetësisë në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 Për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ


të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit në fjalë.

Vendimi nr.01-0031376/25, datës 01/08/2025 për themelimin e Poliklinikës Specialistike me njësinë e Hemodializës në Komunën e Skenderajit.

Pas shqyrtimit të Vendimit nr.01-0031376/25, datës 01/08/2025 për themelimin e Poliklinikës Specialistike me njësinë e Hemodializës në Komunën e Skenderajit, ju njoftojmë se Vendimi është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi.

Rekomandim: të veprohet në pajtim me nenin 20 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi me të cilin përcaktohet që Kujdesi dytësor shëndetësor mund të organizohet edhe në nivelin komunal me kërkesën e Kuvendit përkatës komunal, dhe në pajtim me vendimin e Ministrit të Shëndetësisë.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë		
Kopje:	Kryetari i Komunës së Skenderajt Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Skenderajt Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL		
Përmes:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL		
Nga:	Erbilin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor në MAPL	Date: 01.08.2025 VI-020-483	
Zyrtarët përgjegjës:			
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Donjeta Cakolli, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës		
Lënda:	Shkresë përcjellëse për MSH		
Lloji i aktit:	Vendim		

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar, vendimin nr. 01-351/01-0031376/25 për themelimin e Poliklinikës Specialistike me njësinë e Hemodializës, në Komunën e Skenderajt, i miratuar nga kuvendi i komunës së Skenderajt dhe i nënshkruar nga kryesuesi i kuvendit të komunës së Skenderajt, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenin 3 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimi nr. 01-351/01-0031376/25 për themelimin e Poliklinikës Specialistike me njësinë e Hemodializës në Komunën e Skenderajt.

I miratuar më datë: 31.07.2025

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.08.2025



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA NOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNITETI/COMMUNALiteti/OPSTINA MUNICIPALITETSKUPSTINA NOSOVA
SKENDERAJ

32-334/04-0026564/25

Data 10.07.2025



Republika e Kosovës
Republic Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 58, shkronja h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 50 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës. 03.12.2008, ndërlidhur me nenin 17, parag. 3.2 dhe nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Kryetari i Komunës i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e mbajtur më datë _____, të miratojnë këtë:



PROPOZIM

- I. Miratimin e vendimit për themelimin e poliklinikës specialiste në kuadër të QKMF-së në Komunën e Skenderajt.
- II. Poliklinika Specialiste do të themelohet si institucion i kujdesit dytësor shëndetësor, me qëllim të plotësimit të mungesave ekzistuese në ofrimin e shërbimeve.
- III. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesueses së KK-së





Drejtoria për Shëndetësi

Direkcija za zdravstvo

Department of Health

DATE/A:	07/07/2025
PËR/ZA/TO:	Z. Fadil Nura Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Z. Ilir Havolli U.D Drejtor në QKMF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për iniciimin e themelimit të Poliklinikës Specialistike Publike në Komunën e Skenderajt

I nderuar Kryetar,

Duke marrë parasysh nevojat e mëdha për shërbime shëndetësore të nivelit dytësor në Komunën e Skenderajt dhe kufizimet aktuale në ofrimin e konsultave Specialistike brenda sistemit ekzistues të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH), ju drejtohem me këtë kërkesë për iniciimin e procedurave për themelimin e një Poliklinike Specialistike Publike.

Arsyetimi i Kërkesës:

- Kërkesat për shërbime specialistike janë në rritje të vazhdueshme, duke tejkaluar kapacitetet e KPSH-së.
- Numri i specialistëve në Kosovë është në rritje, por mundësia e punësimit të tyre brenda institucioneve publike mbetet e kufizuar.
- Ligji për Shëndetësi Nr. 04/L-125, Neni 17, pika 3.2 përcakton Poliklinikën Specialistike si institucion të nivelit dytësor, i cili mund të organizohet për të plotësuar boshllëqet ekzistuese në ofrimin e shërbimeve.
- Udhëzimi Administrativ për Kujdesin Parësor Shëndetësor (UA 04/2020) kufizon ofrimin e shërbimeve specialistike brenda KPSH-së, duke e bërë të domosdoshëm një institucion të dedikuar për këtë qëllim.

Kërkesa:

Duke marrë parasysh këto fakte, kërkoj nga Drejtoria për Shëndetësi në Komunën e Skenderajt që të ndërmarrë hapat e nevojshëm për iniciimin e themelimit të Poliklinikës Specialistike Publike.

Konkretisht, kërkoj

1. Shqyrtimin dhe miratimin e kësaj nisme nga ana e Drejtorisë për Shëndetësi.
2. Ngritjen e çështjes për diskutim dhe miratim në instancat përkatëse -Asamblenë Komunale të Komunës së Skenderajt.
3. Hartimin, **përgatitjen e dokumentacionit zyrtar** dhe dërgimin e kërkesës zyrtare për miratim në Ministrinë e Shëndetësisë.

Me besimin se kjo nismë do të sjellë përmirësime të ndjeshme në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Komunës së Skenderajt, pres përgjigjen tuaj dhe mbështetjen në këtë proces.

Me respekt,

Ilir HAVOLLI

U.D. Drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare

Komuna e Skenderajt

26.02.2025



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Republik of Kosovo

Nr. 02-114/01-003987/2
No. 01-09-2011/2
Data



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 58, shkronja h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 50 shkronja h) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385 të datës. 03.12.2008, ndërlidhur me nenin 17, parag. 3.2 dhe nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Kryetari i Komunës i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e mbajtur më datë _____, të miratojnë këtë:

PROPOZIM

- I. Miratimin e **Draft - Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2027** në Komunën e Skenderajt.
- II. Draft - Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore është përgatitur nga Grupi Punues i emëruar nga Kryetari i Komunës, me mbështetjen e UN Women Kosovë, në kuadër të zbatimit të projektit “Nxitja e Fuqizimit të Grave të Zonave Rurale”, i cili po zbatohet në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi (FAO), me fonde të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).
- III. Drafti i cekur në pikën I, ka kaluar procedurat e konsultimit publik konform legjislacionit në fuqi.
- IV. Ky propozim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Bashkëngjitur: Plani Lokal Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2027.

Propozimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesuses së KK-së



Kryetari i Komunës

Fadil Nura



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj – Municipality of Skenderaj

**PLANI LOKAL I VEPRIMIT
PËR
BARAZINË GJINORE**

2025 - 2027

Korrik, 2025

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2025 - 2027 u përgatit nga Komuna Skenderaj me mbështetjen e UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit “Nxitja e Fuqizimit të Grave të Zonave Rurale”, që po zbatohet në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi (FAO), me fonde të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

Grupi Punues

1. Qefserë Dautaj, Zyrtare për Barazi Gjinore, Kryesuese
2. Adelina Spahiu, Kryesuese e Kuvendit Komunal, anëtare
3. Besnik Smakaj, Zyra Ligjore, anëtar
4. Ilmi Kabashi, Sekretaria e Kuvendit, anëtar
5. Besart Geci, Drejtoria për Buxhet dhe Financë, anëtar
6. Ragip Ymeri, Drejtoria Komunale për Arsim, anëtar
7. Valbona Hoti, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare
8. Shehrije Rama, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, anëtare
9. Dritan Sylaj, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar
10. Ganie Kerolli, Drejtoria për Shërbime Publike, anëtar

Ekspertiza teknike nga UN Women:

Diana Cekaj - Berisha, Koordinatore programi
Monika Kocaqi, Konsulente ndërkombëtare

Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës, z. Fadil Nura

Barazia gjinore është themeli i një shoqërie të drejtë dhe demokratike. Komuna jonë mbetet e përkushtuar për të siguruar mundësi të barabarta për të gjithë, përmes zbatimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2027.

Në Kuadër të Planit Lokal të Veprimit për barazinë Gjinore 2025-2027, komuna jonë është e përkushtuar që të identifikojë sfidat, të përcaktojë prioritetet dhe të ndër marrë masa konkrete për përmirësimin e situatës së barazisë gjinore.

Faleminderoj të gjithë akterët që kanë kontribuar në këtë proces, veçanërisht përfaqësuesit e institucioneve vendore dhe partneret tanë ndërkombëtarë. Një falënderim i veçantë i drejtohet UN Women për mbështetjen teknike dhe profesionale.

Le të ecim përpara së bashku, me përkushtim dhe bashkëpunim, drejt një shoqërie më të barabartë për të gjithë.

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE	5
I. HYRJE	6
II. KORNIZA LIGJORE DHE INSITUCIONALE	8
III. METODOLOGJIA	11
IV. VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE	12
V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PLVBGJ 2025 - 2027	15
VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI	18
VII. MATRICA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 - 2027	19

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

ABGJ	Agjencia për Barazinë Gjinore
BDPfA	Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DA	Drejtoria e Administratës
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financë
DBPZHR	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
DGJKP	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
DSHP	Drejtoria për Shërbime Publike
DZHENIT	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm
EU GAP III	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III
GGA	Grupi i Grave Asambleiste
KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
KK	Kuvendi Komunal
KKBGJ	Komisioni Komunal për Barazi Gjinore
KPF	Komiteti për Politikë dhe Financa
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
ON	Organizatë Ndërkombëtare
PKBGJ	Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore
PLVBGJ	Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SIEDNJBGJ	Sektori për Integritet Evropian, Drejtave të Njeriut dhe Barazisë Gjinore
SDG	Objektiv i Zhvillimit të Qëndrueshëm
ZBGJ	Zyrtare/Zyrtar për Barazinë Gjinore
ZK	Zyra e Kryetarit/Kryetares

I. HYRJE

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2025 - 2027 u përgatit nga Komuna Skenderaj, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore, të reflektuara në:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit.
- Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, si dhe tërësinë e ligjeve të vendit të fokusuara tek barazia, mosdiskriminimi dhe fuqizimi i grave.
- Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024 (në proces përditësimi), si dhe tërësinë e kornizës zhvillimore vendore (programe e strategji) për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.
- Instrumente dhe mjete të BE-së të fokusuara tek barazia gjinore, si pjesë e procesit të integritetit, veçanërisht ato që përmbajnë veprimet që duhet të ndërmerren në nivelin lokal – siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

PLVBGJ u përgatit përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike lokale, organizatat e shoqërisë civile, Grupin e Grave Asambleiste, organizatat ndërkombëtare, Kuvendin Komunal dhe me zërat e banoreve dhe banorëve të Komunës së Skenderajt, të cilat / cilët patën mundësi të njihen dhe të japin komentet e tyre mbi këtë dokument përgjatë procesit të konsultimit publik. I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Kosovë në kuadër të zbatimit të projektit “Nxitja e Fuqizimit të Grave të Zonave Rurale”, që po zbatohet në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi (FAO), me fonde të Agjensisë Austriake për Zhvillim (ADA).

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Women, 2011).

Drejtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave. (UN Women, 2011).¹

Siç përshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale², njësitë e vetëqeverisjes lokale janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të avancojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve lokalë, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave³, të rejave dhe të rinjve⁴, vajzave dhe djemve.⁵

Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes lokale. Barazia gjinore prej vitesh është evidentuar si një çështje me përparësi në nivel vendi, e për këtë qëllim edhe në nivelin lokal është punuar e po punohet vazhdimisht. Në nivel vendi, në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024 (në proces përditësimi), i cili bazohet në Ligjin Nr. 05/L -020

¹ Për një listë më të plotë me koncepte mund të vizitoni edhe: <https://eige.europa.eu/thesaurus/browse>

² Tekstin e Kartës mund ta gjeni në: <https://charter-equality.eu/the-charter/observatoire-europeen-en.html>

³ “Gra dhe burra” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore duke filluar nga mbi 29 vjeç, deri në fund të jetës (përfshirë edhe të moshuarat/moshuarit).

⁴ “Të reja dhe të rinj” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 18 - 29 vjeç.

⁵ “Vajza dhe djem” në këtë PLVBGJ nënkupton periudhën moshore nga 0 - 18 vjeç.

për Barazi Gjinore, jepen qartësisht fushat kryesore të ndërhyrjes, si dhe objektivat specifike për zbatimin e të cilave duhet të punojnë së bashku institucionet qendrore, lokale, OJQ-të dhe të gjithë partnerët lokalë, kombëtarë e ndërkombëtarë.

Në zbatim të kornizës ligjore e të politikave në fuqi në lidhje me çështjet e barazisë gjinore, si dhe në përputhje me misionin dhe vizionin e saj, Komuna e Skenderajt, ka emëruar një Zyrtarë për Barazinë Gjinore në Sektorin për Integritet Evropianë, Drejtave të Njeriut dhe Barazi Gjinore, e cila në mënyrë të përvitshme harton dhe zbaton një plan të veprimeve konkrete për përparimin drejt barazisë gjinore. Ky plan e ka gjetur zbatimin me mbështetjen financiare nga komuna dhe donatorë, përmes partneriteteve e bashkëpunimit.

Megjithatë, pavarësisht përparimit të bërë në këtë drejtim në nivel vendor apo komunal, duhet të pranojmë që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhimi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda të njëjtës gjini, vijojnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj.

Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes lokale të marrin parasysh plotësisht integritetin gjinor në politikat, organizimin dhe praktikën e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin ekonomik dhe shoqëror.

PLVBGJ 2025 - 2027 është konceptuar dhe lidhur pikërisht me kornizën ligjore dhe të politikave kombëtare, por mbështetet dhe merr frymëzim edhe nga dokumentet ndërkombëtarë të rëndësishëm, e synon të përafrohet me standardet dhe kërkesat e *acquis* të BE-së për barazinë gjinore.

*Ky Plan vjen gjithashtu edhe si detyrim për t'u hartuar dhe miratuar në përputhje me zbatimin e "Qarkores për zbatimin e masave të veçanta për adresimin e pabarazisë gjinore në nivelin lokal" të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, miratuar në 16.04.2025 dhe përcjellë për zbatim komunave në 21.05.2025.*⁶

Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë plan, janë hartuar duke pasur parasysh faktin që asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve pra të të gjitha/gjithë anëtarëve dhe anëtarëve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore. Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithë përfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PLVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja "në të gjithë diversitetin e tyre".⁷ Përmes saj theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grave, të rejave dhe vajzave (por edhe burrave, të rinjve e djemve) në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë e të ndërthurur, për shkak të seksit, moshës, zonës ku jetojnë, etnisë, aftësive të kufizuara, nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, të qenit prind i vetëm, të qenit viktimë / e mbijetuar / i mbijetuar i trafikimit të qenieve njerëzore, apo formave të tjera të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, statusit të migrantës / migrantit, azilkërkueses / azilkërkuesit, apo për shkak të të qenit "person nën mbrojtje ndërkombëtare" (pra me status refugjateje/refugjati, të përkohshëm dhe nën mbrojtje plotësuese), me status "pa shtetësi", etj.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e PLVBGJ 2025 - 2027, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat partnere

⁶ Sipas pikës 6.2 të kësaj Qarkoreje, Komunitat janë të obliguara që brenda 1 viti nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj qarkoreje, të hartojnë dhe miratojnë Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore...etj.

⁷ Në kuadër edhe të përafërimit të këtij Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore me Planin e Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore – EU GAP III.

në zbatim, afatet kohore, përgjegjësit për monitorim, si dhe kostot e nevojshme për zbatim. Këto patjetër që janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit përkatës dhe dokumentet kryesore ku mbështeten hapat e planifikuar.

II. KORNIZA LIGJORE DHE INSITUCIONALE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut sikurse Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (njohur si CEDAW), Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, apo Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje (e njohur si Konventa e Stambollit), drejtpërdrejt të aplikueshme në legjislacionin vendor dhe në rast konflikti konsiderohet që këto konventa kanë prioritet ndaj akteve dhe ligjeve të nxjerra nga institucionet publike.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës.

Ligji për Barazi Gjinore, garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore synon të sigurojë që barazia gjinore është në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve.⁸

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2027 i Komunës Skenderaj, mbështetet në një tërësi dokumentesh të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Kosovë. Si më kryesoret mund të përmendim:

1. Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:

- “Deklarata universale për të drejtat e njeriut”;⁹
- “Konventa evropiane për të drejtat e njeriut”;¹⁰
- “Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike”;¹¹
- “Konventa ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore”;¹²
- “Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW)”;¹³
- “Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës”;¹⁴
- “Deklarata dhe Platforma për veprim e Pekinit”;¹⁵
- “Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”;¹⁶
- “Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi gratë, paqen dhe sigurinë”;¹⁷
- “Agjenda e Kombeve të Bashkuara për zhvillim të qëndrueshëm, 2030”;¹⁸

⁸ Shih PKBGJ, fq. 11

⁹ <https://unmilk.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/Ahri/AUniversalDeclarationHumanRightsfinal.pdf>

¹⁰ https://prd-echr.coe.int/documents/d/echr/Convention_SQL

¹¹ <https://hrhp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>

¹² <https://unmilk.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/Ahri/Ahri.htm>

¹³ <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Konvent%20CEDAW.pdf>

¹⁴ <https://unmilk.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/Ahri/AConRightsChild.pdf>

¹⁵ <https://avenetwork.org/media/6462066697d99.pdf>

¹⁶ <https://rm.coe.int/168046246b>

¹⁷ <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Rezoluta%201325%20Gruaja%20Paqja%20dhe%20Siguria.pdf>

¹⁸ <https://humanrights.oik-rks.org/goals>

- “Strategjia e barazisë gjinore 2020 - 2025 e Bashkimit Evropian”¹⁹ dhe “Plani i veprimit për barazinë gjinore (GAP III) 2021 – 2025/2027”;^{20,21}
- “Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale”²², etj.

2. Korniza ligjore dhe zhvillimore kombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave:

- “Kushtetuta e Republikës së Kosovës”, neni 7, 21 dhe 22;²³
- “Ligji për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040”;²⁴
- “Ligji për barazi gjinore, nr. 05/L-020”;²⁵
- “Ligji për trashëgiminë në Kosovë nr.2004/26”;²⁶
- “Ligji nr. 06/L-077, për ndryshim- plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës”;²⁷
- “Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, nr.05/L-021”;²⁸
- “Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjerë sendore, nr. 03/L-154”;²⁹
- “Ligji i punës, nr. 03/L-212”;³⁰
- “Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, nr. 08/L-185”;³¹
- “Ligji nr. 08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare”;³²
- “Ligji nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë”;³³
- “Ligji nr. 03/L022, për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme”;³⁴
- “Ligji nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit”;³⁵
- “Ligji nr. 06/L-084, për mbrojtjen e fëmijës”;³⁶
- “Ligji nr. 04/L-125, për shëndetësi”;³⁷
- “Ligji nr. 06/L-026, për azil”;³⁸
- “Ligji nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit”;³⁹
- “Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024”;⁴⁰
- “Strategjia kombëtare për zhvillim - 2030”⁴¹
- “Programi për reforma në ekonomi (PRE) 2022 - 2024”;⁴²

¹⁹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0152>

²⁰ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020JC0017&from=EN>

²¹ Kohëzgjatja e zbatimit të EU GAP III është përcaktuar nga BE deri në vitin 2027. Shih: https://enlargement.ec.europa.eu/news/gender-equality-eu-extends-duration-gender-action-plan-external-action-build-its-achievements-2023-11-21_en

²² https://www.cere.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf

²³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

²⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

²⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>

²⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2407>

²⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18420>

²⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>

²⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2643>

³⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>

³¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=83131>

³² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85111>

³³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2826>

³⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2582>

³⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=66178>

³⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

³⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8666>

³⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16389>

³⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

⁴⁰ <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ABGJ%20Programi%20i%20Kosov%C3%ABs%20p%C3%ABr%20Barazi%20Gjinore%202020-2024.pdf>

⁴¹ <https://kryeministri.rks-gov.net/strategjia-kombetare-per-zhvillim-2030/>

⁴² <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Programi-per-Reforma-ne-Ekonomi-2022-24.pdf>

- “Strategjia për rregullim me të mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021”;⁴³
- “Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026”;⁴⁴
- “Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (PKZMSA) 2022-2026”;⁴⁵
- “Strategjia kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë”⁴⁶ dhe “Plani i veprimit të Strategjisë kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë”⁴⁷;
- “Plani i veprimit për promovim dhe edukim shëndetësor 2023-2025”⁴⁸;
- Qarkorja për zbatimin e masave të veçanta për adresimin e pabarazisë gjinore në nivelin lokal, për gatitur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, miratuar në 16.04.2025 dhe përcjellë për zbatim komunave në 21.05.2025, etj.

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PLVBGJ 2025 - 2027 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët e caktuar sipas fushave të tyre.

Përgjegjëse kryesore për zbatimin e PLVBGJ mbetet **Komuna**. Kjo nënkupton përgjegjësi si për zbatim të drejtpërdrejtë të masave dhe veprimeve të parashikuara, ashtu edhe për koordinimin me institucionet dhe aktorët përkatës, që bëjnë të mundur zbatimin e këtyre masave dhe veprimeve. Pra nëse komuna nuk ka mundësi financiare, njerëzore apo infrastrukturore që të zbatojë drejtpërdrejt një masë apo veprim të caktuar, përgjegjësia e saj është të koordinohet dhe të bashkërendojë veprimet me atë institucion që e ka këtë mundësi, duke përfshirë edhe OJQ, institucionet private, organizatat ndërkombëtare, etj. Zyrtarja për Barazi Gjinore (ZBGJ) mbetet përgjegjëse për një sërë masash dhe veprimesh të parashikuara në PLVBGJ, por, tashmë ky është një plan i të gjithë komunës ndaj dhe përgjegjësia kryesore për këtë plan në tërësi jo domosdoshmërisht bie mbi ZBGJ. Gjithashtu, PLVBGJ 2025 - 2027, i zbërthyer vit pas viti, zëvendëson edhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore që ZBGJ përgatiste dhe paraqiste përpara Kryetarit të Komunës dhe Agjencisë për Barazi Gjinore, në mënyrë të përvitshme.

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin lokal luan edhe Grupi i Grave Asambleiste, të cilat gjithashtu kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për hartimin e këtij Plani. Në vijim, të gjitha institucionet lokale dhe OJQ të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PLVBGJ, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për të zbatuar masa të caktuara të parashikuara në këtë PLVBGJ.

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore, është:

- një mjet praktik i lokalizimit të dokumenteve të rëndësishëm kombëtarë, por edhe ndërkombëtarë në lidhje me barazinë gjinore (veçanërisht instrumentet drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit).
- një dokument i hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, me hapa të mirë përcaktuar, e në përmbajtje të të cilit reflektohen arritjet dhe sfidat e ndeshura ndër vite nga Komuna, në përparimin drejt barazisë gjinore.
- një pasqyrim i qartë i roleve dhe përgjegjësi të domosdoshme për t’u përmbushur brenda Komunës, si dhe ndërmjet Komunës e institucioneve lokale apo organizatave të shoqërisë civile e ato ndërkombëtare, me qëllim zbatimin në praktikë të parimit të barazisë për të gjitha/gjithë gratë, burrat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, në Komunën e Skenderajt.

⁴³ <https://mpb.rks-gov.net/ap/desk/inc/media/010D4102-371B-4279-A99E-B9E73DBFFD2F.docx>

⁴⁴ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ALB-Strategjia-Kombetare-CC%88r-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne-CC%88-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-%E2%80%93-2026.pdf>

⁴⁵ https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/1-PKZMSA-2022-2026_shq.pdf

⁴⁶ <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/2EB649CB-988B-4F74-86ED-926CDE060F0B.pdf>

⁴⁷ <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/223C9285-0D8F-418E-88B3-19C5A8EF4432.pdf>

⁴⁸ <https://msh.rks-gov.net/Documents/DownloadDocument?fileName=Plani42004910.6704.pdf>

III. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PLVBGJ 2025 - 2027 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

- ✓ **Ngritja e Grupit Punues për përgatitjen e këtij plani, me Vendim të Kryetarit të Komunës.** Grupi Punues për përgatitjen e këtij PLVBGJ u ngrit me Vendim të Kryetarit 02-020/01-0019386, me datë 21.05.2025 dhe kishte në përbërje të tij dhjetë zyrtarë / zyrtarë, konkretisht:
 - Qefsere Dautaj, Zyrtare për Barazi Gjinore, Kryesuese
 - Adelina Spahiu, Kryesuese e Kuvendit Komunal, anëtare
 - Besnik Smakaj, Zyra Ligjore, anëtar
 - Ilmi Kabashi, Sekretaria e Kuvendit, anëtar
 - Besart Geci, Drejtoria për Buxhet dhe Financë, anëtar
 - Ragip Ymeri, Drejtoria Komunale për Arsim, anëtar
 - Valbona Hoti, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare
 - Shehrije Rama, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, anëtare
 - Dritan Sylja, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar
 - Ganie Kerolli, Drejtoria për Shërbime Publike, anëtar
- ✓ **Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues.** Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentesh ekzistues të komunës, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kornizës ligjore dhe të politikave ekzistuese kombëtare e lokale, të lidhura me çështjet gjinore.
- ✓ **Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshme për t'u përfshirë në matricën e PLVBGJ 2025 - 2027.** Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, si vlerësimi i arritjeve dhe sfidave të komunës për adresimin e çështjeve të barazisë gjinore, identifikimi i prioritetëve bazuar në analizën e cekur më sipër, marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të dala nga diskutimet me stafin e komunës, etj.).
- ✓ **Konsultimet paraprake brenda komunës dhe hartimi i draft PLVBGJ.** Këto konsultime u zhvilluan me stafin e komunës si dhe në veçanti me anëtarët / anëtarët e Grupit Punues. Që prej fillimit të këtyre konsultimeve u prezantuan instrumente kryesore të rëndësishme ndërkombëtare, sidomos ato të BE-së të lidhura me barazinë gjinore (si për shembull Plani i Veprimit i BE-së për Barazinë Gjinore / EU GAP III, apo Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.). Po kështu u prezantuan edhe prioritetet e cekura në dokumente të rëndësishme kombëtare si Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 - 2024, Plani i Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën i Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III, 2021 – 2025, etj. Më pas u kalua në përgatitjen e draft matricës së PLVBGJ-së, e cila përmbante objektivat strategjike, rezultatet e pritshme, dokumentet se ku referoheshin masat dhe veprimet e parashikuara, objektivat specifike, treguesit në nivel objektiv, së bashku me vlerën bazë (e matur për vitin 2024 ose që do përcaktohet gjatë vitit 2025) dhe vlerën e synuar (target) deri në vitin 2027, rezultatin në nivel të objektivit specifik, si dhe aktivitetet, drejtorinë përgjegjëse për zbatim, partnerët dhe bashkëpunëtorët, afatin kohor, koston për tre vitet, burimin e financimit, treguesit për çdo aktivitet, si dhe përgjegjësit për monitorimin e zbatimit të PLVBGJ.
- ✓ **Postimi në faqen e Komunës për komente dhe sugjerime nga individët dhe grupet e interesit.** Draft PLVBGJ 2025 - 2027 u postua në datën xxxxxxxx në xxxxxxxxx Postimi qëndroi i hapur për komente dhe sugjerime deri në datën xxxxxxxx, duke plotësuar kështu detyrimin për konsultimin publik, në mbështetje të Ligjit për vetëqeverisje Lokale Nr.03L-040 dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna.

- ✓ **Mbajtja e konsultimit publik me banoret dhe banorët e Komunës.** Në përputhje dhe vijim të sa cekur më sipër, Komuna Skenderaj mbajti edhe sesionin e dëgjimit publik në datën xxxxxx, në ora xxxxxx.⁴⁹
- ✓ **Përmirësimi i draft PLVBGJ-së.** Pas seancës së dëgjimit publik dhe në përfundim të të gjithë procesit të konsultimit publik, Grupi Punues bëri edhe përmirësimin e draft PLVBGJ, bazuar në të gjitha komentet dhe sugjerimet e marra.
- ✓ **Kostimi i matricës së PLVBGJ.** Procesi i kostimit të matricës së PLVBGJ ishte një proces tepër i rëndësishëm që gjithashtu mori kohën e tij përgjatë përgatitjes së dokumentit të plotë. Kostimi u krye për secilin nga aktivitetet e parashikuara në matricën e PLVBGJ-së dhe fondet u ndanë sipas burimit të financimit, konkretisht fonde të mbuluara nga komuna, me burime ekzistuese njerëzore, infrastrukture apo financiare, fonde të mbuluara nga donatorët, por edhe fonde për gjetjen e të cilave duhet të bëhen rishikime dhe planifikime në buxhetet përkatëse të viteve të ardhshme, ose duhet të lobohet për t'i siguruar përmes bashkëpunimit me donatorët, subjektet private e OJQ-të (pra hendeke financiar).
- ✓ **Dorëzimi i dokumentit të plotë, të kostuar e përfunduar, për miratim në Kuvendin Komunal.** Pas përgatitjes dhe përfundimit të të gjithë procesit, dokumenti i plotë i PLVBGJ, edhe i kostuar, u dorëzua për miratim në Kuvendin Komunal, duke ndjekur të gjitha hapat, detyrimet dhe afatet ligjore përkatëse.
- ✓ **Miratimi i PLVBGJ në Kuvendin Komunal.** PLVBGJ u miratua në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal në xxxxxx 2025.

Të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në linjë jo vetëm me detyrimet kombëtare, por edhe me metodologjinë e përgatitjes së PLVBGJ-ve siç sugjerohet nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE).⁵⁰

Një rol të rëndësishëm në të gjithë procesin e përgatitjes deri në finalizimin e PLVBGJ ka luajtur mbështetja dhe asistencë teknike e ofruar nga UN Women Kosovë, përmes një ekipi të mirë përgatitur si dhe një konsulenteje⁵¹ të angazhuar për këtë qëllim, në kuadër të zbatimit të Projektit “Nxitja e Fuqizimit të Grave të Zonave Rurale”, që po zbatohet në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi (FAO), me fonde të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

IV. VIZIONI, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Vizioni i PLVBGJ-së adreson:

“Një qeverisje të mirë, gjithëpërfshirëse e të drejtë gjinore, ku gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Skenderajt, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të migrantës/migrantit e azilkërkueses/azilkërkuesit, statusit të “personit nën mbrojtje ndërkombëtare” (me status refugjateje/refugjati, të përkohshëm dhe nën mbrojtje plotësuese), statusit “pa shtetësi”, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.

⁴⁹ Për më shumë shihni postimin e këtij konsultimi në faqen e komunës: xxxxxxxxxxxx

⁵⁰ Për më shumë shikoni në: <https://charter-equality.eu/the-action-plan-step-by-step/definir-un-plan-daction-en.html>

⁵¹ Znj. Monika Kocaqi, konsulente ndërkombëtare.

Parimet⁵² që udhëheqin zbatimin e PLVBGJ, mbështeten kryesisht në parimet që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, siç paraqiten në vijim:

1. Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në të gjithë diversitetin e tyre, përbën një të drejtë themelore. Kjo e drejtë duhet të zbatohet nga organet e vetëqeverisjes lokale në të gjitha fushat e tyre të përgjegjësisë; ajo përfshin gjithashtu edhe detyrimin për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit, të drejtpërdrejta apo të tërthorta.
2. Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëllojshme. Përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore duhet të marrin parasysh dhe të trajtojnë – nga një këndvështrim gjithëpërfshirës, sistematik dhe strukturor – mënyrat se si ndërvepron gjinia me faktorë të tjerë si seksi, raca, ngjyra e lëkurës, origjina etnike ose sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinionet politike dhe çfarëdo opinionesh të tjera, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, origjina në lindje, aftësitë e kufizuara, mosha, ose orientimi seksual.
3. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike. E drejta për barazi të grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve, kërkon që organet vetëqeverisëse lokale të marrin të gjitha masat e duhura dhe të miratojnë të gjitha strategjitë e përshtatshme për promovimin e përfqësimit dhe të pjesëmarrjes së balancuar në të gjitha sferat e vendimmarrjes.
4. Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore. Organet e vetëqeverisjes lokale duhet të nxisin punën për eliminimin e stereotipeve dhe pengesave që krijojnë pabarazi në statusin dhe gjendjen e grave / të rejave / vajzave dhe që janë burimi i vlerësimit të pabarabartë të roleve të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve nga pikëpamja politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore.
5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes lokale është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore. Perspektiva gjinore duhet të mbahet parasysh gjatë hartimit të politikave, metodave dhe instrumenteve që ndikojnë në jetën e përditshme të popullsisë lokale – për shembull përmes përdorimit të teknikave të “vlerësimeve gjinore”, “auditimit gjinor”, “integritetit gjinor”, dhe të “buxhetimit të përgjegjshëm gjinor”. Për arritjen e këtij synimi duhet të analizohen dhe të merren parasysh përvojat e shumta dhe të gjera të grupeve të ndryshme të grave në jetën lokale, si edhe kushtet e jetesës dhe të punës së tyre.
6. Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore. Organet e vetëqeverisjes lokale duhet të hartojnë plane dhe programe veprimi për barazinë gjinore, të mbështetura me burimet financiare e njerëzore të nevojshme për zbatimin e tyre.

Objektivat strategjikë të PLVBGJ.

PLVBGJ 2025 - 2027 përbëhet nga pesë objektiva strategjike, të cilat janë harmonizuar edhe me:

- Ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore,
- Programin e Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024,
- Planin e Zbatimit në Nivel Vendi për Kosovën të Planit të Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III (EU GAP III) 2021-2025,
- Konventën për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW),
- Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit),

⁵² Për shpjegime më të hollësishme mbi secilin parim, mund të referoheni tek teksti i Kartës Evropiane për Barazi në adresën: https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf

- Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit (BDPFA),
- Agjendën 2030, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) 2030,
- Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore të BE-së 2021 – 2025 (EU GAP III),
- Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

Katër objektivat strategjike të PLVBGJ 2025 - 2028 të Komunës Skenderaj, renditen në vijim:

1. Fuqizimi ekonomik dhe promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, për gratë, të rejat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre.
2. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsimin cilësor, kulturë e sport dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, për gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.
3. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre.
4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.

Secila nga këto objektiva strategjike është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PLVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera lokale, organizatat e shoqërisë civile, institucionet private, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënja për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PLVBGJ.

Rezultatet e pritshme, objektivat specifike dhe treguesit

Objektivi strategjik: 1. Fuqizimi ekonomik dhe promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, për gratë, të rejat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre.
Rezultatet e pritshme: 1.a. Pjesëmarrja e grave dhe të rejave në aplikimin dhe përfitimin e subvencioneve të komunës në lidhje me ndërmarrësinë, bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik, e përmirësuar ndjeshëm. 1.b. Mbështetja e komunës me shërbime sociale cilësore e të ndjeshme gjinore, e rritur.
Objektivat specifike: 1.1. Rritja e qasjes së të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime, burime dhe produkte financiare, duke synuar fuqizimin ekonomik të tyre. 1.2. Fuqizimi ekonomik i grave dhe të rejave në zonat rurale të Komunës së Skenderajt, përmes promovimit të pjesëmarrjes së tyre në bujqësi, blegtori, bletari, hortikulturë dhe forma të tjera të prodhimit dhe vetëpunësimit të qëndrueshëm. 1.3. Përmirësimi i qasjes në shërbimet e kujdesit, për gra dhe burra, të reja e të rinj, vajza e djem, në të gjithë diversitetin e tyre.
Treguesit në nivel objektiv: 1.1.a. Numri i granteve të ndara për gratë dhe të rejat në raport me totalin e granteve. 1.2.a. Përqindja e grave fermere që ndjekin trajnimet e organizuara nga komuna 1.3.a. Numri i përfituesve të shërbimeve sociale të ndarë sipas gjinisë dhe grupmoshave.
Objektivi strategjik: 2. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsimin cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, për gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.
Rezultatet e pritshme: 2.a. Numri i të rejave e vajzave, të rinjve e djemve në të gjithë diversitetin e tyre, të përfshira në arsim cilësor e në procesin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, rritur ndjeshëm.

2.b. Mundësitë e barabarta për angazhim dhe vlerësim të figurave të artit, kulturës e sportit, për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat e djemtë, të përmirësuara.
Objektivat specifike: 2.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejtat, gratë dhe djemtë, të rinjtë, burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre. 2.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në art, kulturë dhe sport.
Treguesit në nivel objektiv: 2.1.a. Numri i vajzave, të rejave dhe grave nga të gjitha grupet, të përfshira në shërbime cilësore të arsimit dhe formimit profesional. 2.2.a. Numri i grave të rejave dhe vajzave që promovohen si modele të suksesshme në art, kulturë dhe sport.
Objekti strategjik: 3. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.
Rezultatet e pritshme: 1.a. Pjesëmarrja e të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, e përmirësuar. 1.b. Planet e zhvillimit dhe ndërhyrjes në të gjitha fushat, si dhe programet buxhetore të Komunës, me perspektivën gjinore të integruar.
Objektivat specifike: 3.1. Nxitja e pjesëmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike e publike, duke luftuar stereotipet gjinore, diskriminimin dhe disavantazhimin e shumëfishtë. 3.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.
Treguesit në nivel objektiv: 3.1.a. Numri i grave, të rejave e vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, të informuara mbi të drejtat dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë në vendimmarrjen politike e publike. 3.2.a. Përqindja e buxhetit komunal dedikuar veprimeve për fuqizimin e grave dhe përparimin drejt barazisë gjinore.
Objekti strategjik: 4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.
Rezultatet e pritshme: 4.a. Edukimi mbi shëndetin seksual e riprodhues mes profesionisteve/profesionistëve dhe në komunitet, merr rëndësi të veçantë. 4.b. Vendimmarrja tek vajzat, djemtë, të rejtat, të rinjtë, gratë dhe burrat për shëndetin seksual e riprodhues, e përmirësuar ndjeshëm.
Objekti specifik: 4.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.
Tregues në nivel objektiv: 4.1.a. Numri i grave, të rejave, vajzave, si dhe burrave, të rinjve e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, me akses të shtuar në kujdesin dhe shërbimet shëndetësore seksuale dhe riprodhuese.

V. KOSTO PËR ZBATIMIN E PLVBGJ 2025 - 2027

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në matricën e PLVBGJ 2025 - 2027 shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zbërthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Komuna (me burimet ekzistuese njerëzore, financiare e infrastrukturore), kosto që mbulohet nga donatorët dhe palët e treta, si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeuku financiar).

Është e rëndësishme të theksohet se ndonëse një pjesë të mirë të aktiviteteve Komuna e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra zyrtareve / zyrtarëve, të cilat/cilët

aktualisht marrin një pagë fikse, sallave/ambienteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënie në dispozicion të makinës dhe materialeve kancelarike të cilat blihen në total për të gjithë institucionin, ose përmes granteve dhe subvencioneve, etj.), në këtë Plan Lokal Veprimi për Barazinë Gjinore 2025 - 2027 evidentohet edhe vlera përkatëse e këtij kontributi, me qëllim që gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij, të mundësohet vlerësimi edhe përmes kosto-eficencës. Është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që këto përllogaritje janë bërë për minimumin e vlerave që do të kërkonte organizimi i aktiviteteve të propozuara.

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2027, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PLVBGJ nuk merr jetë, Komuna duhet të përfshijë në kornizën e parashikimeve buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në këtë PLVBGJ. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimi nga vetë Grupi i Grave Asambleiste për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve/masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Komunës, është domosdoshmëri.

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Lokal të Veprimit, *duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara*, bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo KAB-et e Komunës, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar sidomos në periudhën e përgatitjes së KAB-eve dhe buxheteve vjetore, për të përfshirë në to masat dhe veprimet e parashikuara në matricën e PLVBGJ, sipas ndarjeve në vite.

Nga përllogaritjet e bëra rezulton se kostot në tërësi për zbatimin e PLVBGJ 2025 - 2027 janë në vlerën **2,883,364 EUR**. Nga këto:

- **2,292,454 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 1. Fuqizimi ekonomik dhe promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, për gratë, të rejat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre.
- **20,561 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 2. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsimin cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, për gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.
- **52,630 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 3. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.
- **517,719 EUR** janë kosto për zbatimin e objektivit strategjik 4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.

Në totalin e koston **2,883,364 EUR** të nevojshme për zbatimin në tërësi të PLVBGJ 2025 - 2027 për të gjithë kohëzgjatjen e tij (tre vite):

- **2,646,086 EUR janë kosto që do të mbulohen nga Komuna** (me stafin ekzistues dhe me kontribut në natyrë – salla, mjete, etj.), pra të cilat nuk kanë nevojë të përllogariten si shtesë në buxhet, sepse edhe burimet njerëzore edhe infrastrukurore ekzistojnë. Këtu përfshihen edhe grante apo subvencionime të planifikuara për fusha të caktuara dhe për banorët dhe banorët në të gjithë diversitetin e tyre dhe vit pas viti do maten se sa kanë përfituar gratë, të rejat dhe vajzat në veçanti.
- **234,900 EUR janë kosto që mbulohen nga donatorë** të ndryshëm (të cilët kanë dakordësuar paraprakisht gjatë përgatitjes së draft PLVBGJ-së).
- **2,378 EUR (ose 8% e totalit) janë hendek financiar**, për të cilin komuna do të përpiqet të sigurojë fondet përkatëse vit pas viti, me donacione, ose duke bërë parashikimet përkatëse në buxhetet vjetore dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore, duke filluar nga KAB 2026 - 2028

Objektivat strategjikë	Objektivat specifike	Gjithsej kosto për tre vjet	Komuna	Donatorë të konfirmuar	Hendek financiar
1. Fuqizimi ekonomik dhe promovimi i të drejtave	1.1. Rritja e qasjes së të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre,	520,514 EUR	286,114 EUR	234,400 EUR	0 EUR

ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, për gratë, të rejat dhe vajzat, në të gjithë diversitetin e tyre.	në shërbime, burime dhe produkte financiare, duke synuar fuqizimin ekonomik të tyre.				
	1.2. Fuqizimi ekonomik i grave dhe të rejave në zonat rurale të Komunës së Skenderajt, përmes promovimit të pjesëmarrjes së tyre në bujqësi, blegtori, bletari, hortikulturë dhe forma të tjera të prodhimit dhe vetëpunësimit të qëndrueshëm.	1,133,000 EUR	1,133,000 EUR	0 EUR	0 EUR
	1.3. Përmirësimi i qasjes në shërbimet e kujdesit, për gra dhe burra, të reja e të rinj, vajza e djem, në të gjithë diversitetin e tyre.	638,940 EUR	638,940 EUR	0 EUR	0 EUR
Gjithsej Objektivi strategjik 1:		2,292,454 EUR	2,058,054 EUR	234,400 EUR	0 EUR
2. Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsimin cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, për gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.	2.1. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejat, gratë dhe djemtë, të rinjtë, burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre.	5,561 EUR	3,783 EUR	0 EUR	1,778 EUR
	2.2. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në art, kulturë dhe sport.	15,000 EUR	15,000 EUR	0 EUR	0 EUR
Gjithsej Objektivi strategjik 2:		20,561 EUR	18,783 EUR	0 EUR	1,778 EUR
3. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë	3.1. Nxitja e pjesëmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen	21,077 EUR	20,577 EUR	500 EUR	0 EUR

diversitetin e tyre.	politike e publike, duke luftuar stereotipet gjinore, diskriminimin dhe disavantazhimin e shumëfishtë.				
	3.2. Rritja e masave dhe veprimeve të Komunës që marrin parasysh e zbatojnë integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.	31,553 EUR	30,953 EUR	0 EUR	600 EUR
Gjithsej Objektivi strategjik 3:		52,630 EUR	51,530 EUR	500 EUR	600 EUR
4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.	4.1. Rritja e qasjes së grave, të rejave, e vajzave në të gjithë diversitetin e tyre, në shërbime cilësore shëndetësore dhe të shëndetit seksual e riprodhues.	517,719 EUR	517,719 EUR	0 EUR	0 EUR
Gjithsej Objektivi strategjik 4:		517,719 EUR	517,719 EUR	0 EUR	0 EUR

Për më shumë detaje, lutemi referohuni tek Matrica e Planit Lokal të Veprimit në vijim.

VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Procesi i raportimit për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga Drejtoria/ Njësia përgjegjëse për zbatimin e aktivitetit tek *Zyra e Kryetarit/Kryetares*.

Menjëherë pas miratimit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2027, si hap i parë i zbatimit të tij, do të mblidhen të dhënat për vlerën bazë të treguesve në nivel të objektivave specifike. Po kështu do të hartohen edhe fletët e treguesve me informacionin që duhet të mblidhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifike. *Raportimet në bazë të objektivave specifike* do të përgatiten *çdo 6 muaj* ose në bazë të kërkesës së Zyrës së Kryetarit/Kryetares.

Me miratimin e këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore, **do të ngrihet me vendim të Kryetarit/Kryetares edhe një Komitet Komunal për Barazinë Gjinore**, në përputhje dhe zbatim të Qarkores së MAPL për adresimin e pabarazive gjinore në nivelin lokal. Përbërja dhe funksionimi i KKBGJ përcaktohen në 5.4.1 të Qarkores. Anëtarët/anëtarët e KKBGJ duhet të kenë njohuritë e duhura edhe për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve dhe objektivave specifike të planit.

Monitorimi i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit në nivel të objektivave do të kryhet nga **Kuvendi Komunal**, në vijim dhe mbështetje të monitorimit të brendshëm që do të kryhet nga **Komiteti Komunal për Barazinë Gjinore** që do të ngrihet në nivel komunal. Raportet e përgatitura do të përcillen edhe tek Grupi i Grave Asambleiste dhe sipas nevojës/kërkesës edhe në Agjencinë për Barazi Gjinore, si dhe në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Bazuar në monitorimin e kryer, PLVBGJ *duhet të rishikohet dhe përmirësohet* në mënyrë periodike dhe të paktën çdo një vit nga data e fillimit të zbatimit të tij.

VII. MATRICA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 - 2027

OBJEKTIVI STRATEGJIK:	1. FUQIZIMI EKONOMIK DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE EKONOMIKE, SOCIALE DHE TË PUNËSIMIT TË DENJË, PË GRATË, TË REJAT DHE VAJZAT, NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE										
